



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AAB Construction shpk" të datës 09.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza" me nr. të prokurimit 616-25-1686-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AAB Construction shpk" të datës 09.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza" me nr. të prokurimit 616-25-1686-5-2-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i datës 13.06.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AAB Construction shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 09.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza" me nr. të prokurimit 616-25-1686-5-2-1.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1-"Gjatë vlerësimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues (AK) nuk e ka marrë në konsideratë Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), Nenin 61, që ka të bëjë me Tenderët Jo-Normalisht të Ulët".

P.2.-“Idriz Krasniqi nuk përmbush kërkesën pasi certifikata e lëshuar ISO 9606-1:2018 është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për testimin dhe certifikimin e aftësive të saldatorëve për saldimin me dorë të materialeve metalike- nuk ka të bëjë fare me manovrimin e mjeteve të punës si dhe i njëjti punëtor kontaktën e punës ka një kontratë e cila është për kohë të caktuar e cila ka skaduar më -31.12.2024. **Musa Krasniqi** nuk përmbush kërkesën pasi certifikata e lëshuar ISO 9606-1:2018 është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për testimin dhe certifikimin e aftësive të saldatorëve për saldimin me dorë të materialeve metalike nuk ka të bëjë fare me manovrimin e mjeteve të punës si dhe i njëjti punëtor kontaktën e punës ka një kontratë e cila është për kohë të caktuar e cila ka skaduar më 31.12.2024. **Ibrahim Morina** – për punëtorin në fjalë ka prezantuar certifikatën ndërsa kontrata e punës është një kontratë për kohë të caktuar e cila ka skaduar më -31.12.2024”.

P.3.-“Në dosjen e tenderit është kërkuar në kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale kërkesa 6. Për paisjet -që të ofrohet një Kamion kiper me kran me peshe ngarkese max. 1.5 tonë- në këtë procedurë ky GOE ka ofruar marrëveshje me Sh.Zejnullahu paisjen e cila nuk përmbushë kërkesën pasi që ka prezantuar Kamionetë kiper me vinç dhe ja Kamion sipas kërkesës në dosjen e tenderit. Në dosjen e tenderit është kërkuar që të prezantohen certifikatat iso 45001-2018-, iso9001-2015, iso 14001-2015, ISO 39001-2012, Lulishtja Buqaj nuk ka prezantuar certifikatën valide ISO 39001-2012, për shkak se në vet certifikatën e bashkëngjitur është e shkruar qartë se kjo certifikatë mbetet e vlefshme me anën e kryerjes me sukses të mirëmbajtjeve vjetor brenda ciklit të certifikimit. Certifikata ISO 39001-2012 është lëshuar me datë 02 mars 2023, kurse OE Lulishtja Buqaj nuk ka ofruar dëshmi se ka kryer mirëmbajtjen vjetore e cila në bazë të kërkesës së AK është dashur të bëhet deri me datën 16.04.2025. Pa e kryer mirëmbajtjen, Certifikata ISO 39001-2012 nuk vazhdohet automatikisht, rrjedhimisht për OE Ankues, certifikata e OE Lulishtja Buqaj është e skaduar”.

P.4.-“Certifikatat ISO janë ofruar vetem nga lideri i grupit, mirpo nuk ka paraqit ISO standardet dhe per anëtarin e grupit”.

Lidhur me pretendimin P1 – Komisioni vlerësues ka kërkuar sqarime shitesë nga OE dhe me ç’rast ka konfirmuar se OE nuk ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin P2 – është gjetur se kontratat e prezantuara nga tenderuesi i rekomanduar evidentohet të jenë skaduar me datë 31.12.2024. Prandaj me rastin e rivlerësimit komisioni vlerësues duhet të shqyrtoj mundësinë për të kërkuar sqarime shitesë nga ky OE me qëllim që të konfirmoj nëse kontratat e punës janë vazhduar apo jo. Prandaj pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin P3 – certifikatat ISO janë valide dhe sipas kërkesave të DT. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin P4 – certifikatat ISO janë parashtruar në kuptim të kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional dhe si të tilla këto kërkesa do të trajtohen si të përmbushura nëse dëshmojnë nga cilido anëtar i GOE. Pretendimi është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e dytë. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 11.06.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.